



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0202

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AL Engineering SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të Komuna Rahovec në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbikëqyrja e Investimeve Kapitale në Komunën e Rahovecit", me numër të prokurimit 623-23-363-2-2-1, me 14/07/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet pjesërisht**, si e bazuar ankesa e OE AL Engineering SH.P.K. me nr. 2023/0202, e datës 12/04/2023, kurse vendimi i AK Komuna Rahovec lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbikëqyrja e Investimeve Kapitale në Komunën e Rahovecit" me numër të prokurimit 623-23-363-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e
Operatorit Ekonomik AL Engineering SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me datën 31.01.2023, Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Mbikëqyrja e Investimeve Kapitale në Komunën e Rahovecit" me numër të prokurimit 623-23-363-2-2-1.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është i datës 22. 03. 2023. Kundër vendimit të AK-së me datën 27.03.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim operatori ekonomik ankues AL Engineering SH.P.K, të cilën kërkesë me datën 29.03.2023 e ka refuzuar autoriteti kontraktues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "AL Engineering SH.P.K."- Prishtinë, me datën 12.04.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0202, lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 25/04/2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar
Të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit në mungesë të ofertave të përgjigjegjshme

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues që ka të bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit për Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listë te paktën këtë staf profesional

1.5. Inxhinier i Diplomuar në Inxhinieri Makinerike ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

- Dëshmitë që duhet të ofrohen për të gjitha Kërkesat 1
- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;
- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues me ofertën ka dorëzuar edhe diplomën e masterit për Mehmet Zeqiraj e cila është për Maaster i Shkencave teknike. Poashtu me ofertë ka dorëzuar edhe CV-në e të njëjtit në të cilën te edukimi tregohet kualifikimi i fituar dhe universiteti i ndjekur e cila është si me poshtë: Ne procedurën e ankimimit OE ankues e ka bashkangjitur edhe diplomën të dhënat e te cilës përputhen me të dhënat e paraqitura ne CV. Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja në përputhje me UPP 001/2023 nenin 10.1 është dashur të kërkojë sqarime shtesë prandaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues që ka të bëjë me kërkesën:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1.7. Inxhinier i Diplomuar i Komunikacionit ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

- Dëshmitë që duhet të ofrohen për të gjitha Kërkesat 1
- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;
- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ne ofertën e tij ka dorëzuar diplomën e masterit për Lekë Sina nga Universiteti i Tiranës ne Inxhinieri Mekanike profili: Transport. I njëjti ka bashkangjitur edhe vendimin nga Këshilli kombëtar për njohje.

Eksperti shqyrtues vlerëson se programet e publikuara ne webfaqen e Universitetit te Prishtinës është edhe drejtimi “Komunikacion dhe Transport” në të njëjtin drejtim. Në vendimin e AK-se është sqaruar se vendimi për njohjen nuk e sqaron se a është i barasvlershëm me atë qe kërkohet në dosjen e tenderit. Eksperti shqyrtues duke pas parasysh specifiken e kërkesës dhe dokumenteve te dorëzuara nga OE ankues është dashur qe te aplikohet nga AK neni 72 i LPP-se por duke pas parasysh përgjigjet në pretendimet, eksperti shqyrtues vlerëson se në këtë fazë nuk do të ndërroj rezultati përfundimtar i procedurës. Prandaj si përfundim eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues qe ka te bëjë me kërkesën e dosjes së tenderit:

1.9. Inxhinier i Diplomuar ose Bachelor në Inxhinieri Softverike (IT), me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit, (i njëjti duhet të jetë i certifikuar ne Cisco Certified Netëork Associate (CCNA));

- Dëshmitë që duhet të ofrohen për të gjitha Kërkesat 1
- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt;
- CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;

Dëshmitë që duhet të ofrohen për kërkesën 1.9; 1.10 ; 1.11

- Certifikata përkatëse – Kopje të noterizuar;

Eksperti shqyrtues sqaron se ne baze te dokumentit zyrtar te akademisë CISCO certifikimet bëhen ne disa fusha.

Fusha “Operating Systems and IT” dhe “Netëorking” janë dy fusha te veçanta. Certifikimi CCNA është e përcaktuar ne fushën e rrjeteve (Netëorking) derisa IT Essentials është nen “Operating Systems and IT”.

OE ankues me ofertën e tij ka dorëzuar diplomën në emër te Ardit Selimi i cili është i certifikuar ne fushën IT Essentials e që nuk është fushë e njëjtë me atë të kërkuar në bazë të dosjes së tenderit prandaj në bazë të nenit 10.1 te RRPP AK-ja ka vlerësuar drejt.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Dëshmitë që duhet të ofrohen për kërkesën 1.9; 1.10 ; 1.11

- Certifikata përkatëse – Kopje të noterizuar;

Duke ju referuar kërkesës se dosjes se tenderit eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa e AK-se nuk e specifikon se eksperti duhet të jete i certifikuar (njëjës) por kërkohet te jete i pajisur me certifikata që nënkuptohet se kërkohen certifikata në shumës. Për me tepër AK-ja nuk ka kërkuar që përvoja të dëshmohet pas certifikimit por që e ka përdorur si arsye të eliminimit.

AK-ja me rastin e vlerësimit për këtë pikë nuk ka vepruar në përputhje me Nenin 56.3 të LPP se Dispozitat e të gjitha shprehjeve gjegjëse të kësaj lloji të detyrës së Konstitucione

Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Prandaj si përfundim eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor për këtë pretendim është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin e OE ankues për mosplotësimin e kërkesës nga ana e grupit të OE të rekomanduar për kontratë:

Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte (Mbikëqyrje të projekteve), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 120,000.00 €

Dëshmia 2 Lista e projekteve të kryera në lëmin e shërbimeve të njëjte (Mbikëqyrje të projekteve), të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, dhe dëshmitë e përfundimit Referenca/t ose procesverbali/et e pranimit teknik

Eksperti shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë vlerëson se grupi i OE të rekomanduar për kontratë kanë dorëzuar listën e kontratave të realizuara si më poshtë:

Lideri i Konzorciumit: Arch Empire

Kontrata me nr 1 – 35,999.00 € (referenca e specifikon vlerën e kontratës për mbikëqyrje)

Kontrata me nr. 2 – 3,000.00 €

Kontrata me nr. 3 – 8,020.00 €

Kontrata me nr. 4 – 6,770.00 €

Kontrata me nr 5 – 4,125.00 €

Kontrata me nr. 6 - 992.00 €

Kontrata me nr. 7 – (nuk mund te llogaritet sepse nuk është e përfunduar)

Anëtari i Grupit Eng Idea Shpk

Kontrata me nr. 1 – (kontrata e njëjtë me kontratën e Liderit te konsorciumit dhe është llogaritur lart)

Kontrata me nr. 2 – 24,320.00 €

Kontrata me nr. 2 – 20,000.00 €

Duke pas parasysh kërkesën e dosjes se tenderit te Kërkesa 2 si dëshmi është kërkuar që projektet e kryera të janë “në lëmin e shërbimeve të njëjtë (Mbikëqyrje të projekteve)” eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjatë vlerësimit ka dështuar ta bëjë vlerësimin në përputhje me Neni 59 k amini i, le ë imi d e K a a imi i en e ë e

Autor eti o tra tu s o të o d o ë n ë e er itë p g g h m et m n e t n e i në a ë ë htë ë p ut h ëri e të g tha ë e at e ara htruara në n o t n e o trat s d e n ë d en e t e d .

Si dhe nenin 10.1 te UPP 001/2023

Eksperti shqyrtues poashtu vlerëson se AK-ja ju ka referuar interpretimit të KRPP-se të datës 22.11.2022 në mënyrë jo të drejtë sepse interpretimi është në rastin kur kërkohet lista e kontratave duke mos specifikuar një fushë të veçantë të realizimit të kontratave që është në kundërshtim me atë çka kërkohet me dosjen e tenderit të AK-se “në lëmin e shërbimeve të njëjtë (Mbikëqyrje të projekteve)”.

10. 22.11.2022 Shembull: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën 3.000.000 euro kontrata kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Dëshmia dokumentare 1: Lista e kontratave kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin

Eksperti shqyrtues vlerëson se duke u bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit, listën e kontratave të dorëzuara me ofertë grupi i OE nuk e plotëson Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kërkesa 2. Për më tepër eksperti shqyrtues mendon se grupi i OE të rekomanduar për kontratë në asnjë variant me këtë procedurë të prokurimit nuk mund të jenë të përgjegjshëm sepse nuk e kalojnë pragun e kërkuar sipas dosjes së tenderit.

Prandaj pas shqyrtimit të pretendimit dhe duke marrë për bazë dokumentet e ngritura në sistemin e e-prokurimit Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i

shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar se në raportin e ekspertizës së tij.

- Përfundim -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK nuk ka vepruar në harmoni me dispozitat e cituara si më sipër të LPP dhe nuk ka zbatuar në përpikëri nenin 59 të LPP. Në kuptim të kësaj dispozite, Autori i kësaj lënde është detyruar të tregojë se si ka marrë parasysh të gjitha aspektet e kësaj lënde dhe se si ka marrë parasysh të gjitha aspektet e kësaj lënde. Me çrast AK duhet të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj integritetin e vet procesit të prokurimit dhe të kulturës institucionale dhe të profesionalizuar.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret dhe në mungesë të ofertave të përgjegjshme të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplisit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - AL Engineering SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: